

PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE



AKTIVITETI: Veprimtaritë e lëndës së drurit

ID 7.10.b: Përveç rasteve të përmendura në kategori të tjera të kësaj Shtojce, prodhimi i produkteve të përbëra tërësisht apo kryesisht nga druri n.q.s. veprimtaria përfshin: sharrimin, shpimin, fërkimin me rërë, gdhendjen, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit e lëndës së drurit.

VENDI I ZHVILLIMIT TE AKTIVITETIT: Fier, LUSHNJE; Lagja Xhevdet Nepravishta, Nr pasurie 28/26, Zone Kadastrale 8571, Godine 1 kateshe (ish reparti i pllakave bituminoze).

ZHVILLUESI: Merilian Gjinaj (P.F)

PËRGATITI RAPORTIN: Dr. Gazmend ZENELI

Licence: LN-9639-05-2015

NIPT: L51720027C

TABELA E PERMBAJTJES

1	INFORMACIONE TE PERGJITHSHME	4
1.1	INFORMACION MBI KËRKUESIN	4
1.2	INFORMACION MBI INSTALIMIN/IMPIANTIN	5
1.3.	PRONËSIA E TOKËS	7
1.4.	PRONËSIA E IMPIANTIT	7
2.	PERSHKRIMI I AKTIVITETIT DHE NDIKIMET E MUNDSHME	8
2.1.	PERSHKRIM I MENYRES SE FUNKSIONIMIT TE INSTALIMIT	8
2.2.	MENAXHIMI I INSTALIMIT	12
2.3.	NDIKIMI NE MBULESEN BIMORE	13
2.4.	SHKARKIMET	14
3.	MONITORIMI	16
3.1.	PLANI I MENAXHIMIT DHE MONITORIMIT TE MJEDISIT	16
3.2.	KERKESAT LIGJORE PER KRYERJEN E MONITORIMIT.	16
3.3.	MONITORIMI I ELEMENTEVE TE MJEDISIT.	17
4.	PERSHKRIMI I MASAVE TE TJERA PARANDALUESE TE PLANIFIKUARA	19
4.1.	MASA LEHTËSUESE TË PROPOZUARA	19
4.2.	MASA LEHTËSUESE TË TJERA TE KERKUARA	19
5.	REHABILITIMI, NDERPRERJA E VEPRIMTARISE, RIFILLIMI DHE KONTROLI PAS NXJERRJES NGA PERDORIMI	21

LISTA E FIGURAVE

Figure 1. Ortofoto e vendodhjes se objektit per prodhim paletash (Burimi ASIG)	6
Figure 2. Pamje e ambienteve te brendshme te instalimit per prodhim paletash	10
Figure 3. Kabina e transformatorit e vendosur ne pjesen e pasme te godines	10
Figure 4. Produkti perfundimtar (paleta) gati per transport	11
Figure 5. Pamje e catise me panele fotovoltaike per prodhim energjie per instalimin.....	11
Figure 6. Pamje e ambienteve te jashtme te instalimit	12
Figure 7. Bimesi e degraduar ne objektet ne afersi te instalimit	14

1 INFORMACIONE TE PERGJITHSHME

1.1 INFORMACION MBI KËRKUESIN

Emri i Kompanisë	Merilian GJINAJ
Statusi Ligjor	Person Fizik
Ortaket/Aksionerët e Kompanisë(sipas Ekstraktit të lëshuar nga QKR)	Merilian GJINAJ
Adresa e zyrës qendrore të Kompanisë	Fier, LUSHNJE; Lagja Xhevdet Nepravishta, Nr pasurie 28/26, Zone Kadastrale 8571, Godine 1 kateshe (ish reparti i pllakave bituminoze).
Adresa postale e Kompanisë, nqs ndryshon nga adresa e mësipërme	-
Numri i regjistrimit të Kompanisë(NIPT)	L64005402V
Kodi kryesor i aktivitetit (sipas kullonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit nr 10448, date 14.7.2011 “Per lejet e mjedisit”)	Veprimtaritë e lëndës së drurit ID 7.10.b: Përveç rasteve të përmendura në kategori të tjera të kësaj Shtojce, prodhimi i produkteve të përbëra tërësisht apo kryesisht nga druri n.q.s. veprimtaria përfshin: sharrimin, shpimin, fërkimin me rërë, gdhendjen, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit e lëndës së drurit
Kodi SNAP ¹	n/a
Kodi NOSE-P ²	n/a
Numri i Punonjësve	12
Telefoni	+355 69 5417058
E-mail	meriliangjinaj@live.com

¹ Nomenklatura e zgjedhur për burimet e ndotjes së ajrit, të specifikuar në Aneksin 1 të Udhëzimit të Kërkesës për Leje Mjedisi për kërkuesit

² Nomenklatura për burimet e shkarkimit, të specifikuar në Aneksin 1 të Udhëzimit të Kërkesës për Leje Mjedisi për kërkuesit

1.2 INFORMACION MBI INSTALIMIN/IMPIANTIN

Emri i instalimit/impianit ³	Veprimtaritë e lëndës së drurit
Adresa ku ndodhet apo do të ngrihet instalimi/impianiti	Rruga “Xhevdet Nepravishta”, Zona Kadastrale 8571, Ndertesa me Nr. Pasurie 28/26, ish reparti i pllakave bituminoze, Lushnje
Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4	<ol style="list-style-type: none"> 1. X =4391655.025 Y =4533525.113 2. X= 4391713.679 Y =4533201.591 3. X= 4391706.732 Y = 4533194.109 4. X= 4391648.213 Y = 4533244.209
Kategoritë e aktiviteteve/veprimtarive industriale të cilat duhet të kërkojnë leje mjedisi	ID 7.10.b: Përveç rasteve të përmendura në kategori të tjera të kësaj Shtojce, prodhimi i produkteve të përbëra tërësisht apo kryesisht nga druri n.q.s. veprimtaria përfshin: sharrimin, shpimin, fërkimin me rërë, gdhendjen, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit e lëndës së drurit.
Kapaciteti i projektuar	Sharrimi dhe perpunimi deri ne 10.000 m ³ / vit i lendes drusore

³ Sipas kullonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Për lejet e mjedisit



Figure 1. Ortofoto e vendodhjes se objektit per prodhim paletash (Burimi ASIG)

1.3. PRONËSIA E TOKËS

Emri/adresa e pronarit/pronarëve të tokës, Numri i identifikimit të pronës sipas dokumentit të lëshuar nga ZRPP ku janë ndërmarrë (nqs ndryshojnë nga ato të kërkuesit) apo do të ndërmerren aktivitetet (nqs ndryshojnë nga ato të kërkuesit)

Emri dhe mbiemri i pronarit/pronarëve	Merilian GJINAJ
Të dhëna për pronësinë e tokës sipas dokumentit të lëshuar nga ZRPP	Toka e blere me kontrate shitje 586 rep, 266 KOL, DATE 26.02.2021. Regjistruar me Nr. 014599 date 01.03.2021
Adresa	Rruga “Xhevdet Nepravishta”, Zona Kadastrale 8571, Ndertesa me Nr. Pasurie 28/26, ish reparti i pllakave bituminoze, Lushnje
Informacion për kontratën e qerasë nëse ka Nr. i kontratës së qerasë nëse kërkuesi nuk është pronar i tokës deri në këtë moment	N/A

1.4. PRONËSIA E IMPIANTIT

Emri dhe adresa e pronarit të impiantit ku kryhet aktiviteti, si dhe informacion mbi kontratën e qerasë nëqoftëse kërkuesi nuk është pronari i impiantit.

Emri dhe mbiemri i pronarit/pronarëve	Merilian GJINAJ P.F
Adresa	Rruga “Xhevdet Nepravishta”, Zona Kadastrale 8571, Ndertesa me Nr. Pasurie 28/26, ish reparti i pllakave bituminoze, Lushnje
Informacion mbi kontratën (qeradhënësi dhe qeramarrësi afati i kontratës, mënyrat e përfundimit të kontratës; periudha e vlefshmërisë) Bashkëngjisni një kopje të kontratës së qerasë	Nuk ka kontratë qeramarrje pasi është në zotërim të z. Merilian Gjinaj

2. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT DHE NDIKIMET E MUNDSHME

Subjekti Merilian GJINAJ (P.F) është regjistruar pranë QKR-se me datë 05/04/2016, me numer NIPT-ti L64005402V. Vendi i ushtrimit të aktivitetit Fier, LUSHNJE; Lagja Xhevdet Nepravishta, Nr pasurie 28/26, Zone Kadastrale 8571, Godine 1 kateshe (ish reparti i pllakave bituminoze).

Subjekti ushtron aktivitetin e tij në fushën e Prodhim e tregtim paletash, kosha, amballazhe druri për fruta-perime, import-eksport. Prodhim fidanesh, pyllëzime dhe shfrytëzim pyjor

Fusha e veprimtarisë e subjektit do të jetë:

Veprimtaritë e lëndës së drurit. ID: 7.10 b Përveç rasteve të përmendura në kategori të tjera të kësaj Shtojce, prodhimi i produkteve të përbëra tërësisht apo kryesisht nga druri në veprimtaria përfshin: sharrimin, shpimin, fërkimin me rërë, gdhendjen, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit.

2.1. PERSHKRIM I MENYRES SE FUNKSIONIMIT TE INSTALIMIT

Trupat me anë të një makine transportuese vendosen në platformën e trupave përpara sharrës automatike. Vendoset trupi i sharrës në karrel dhe realizohet sharrimi me modelet maksimale. Pas sharrimit derrasat kalojnë në circular dhe në diskun pendul.

Derrasat prodhohen në dimensione të ndryshme sipas porosive.

Sharrimi i drurit është një cikël veprimesh duke përdorur një larmi teknologjish që synojnë marrjen e lëndës drusore nga druri i rrumbullakët i pershtasëm për përdorim të metejshëm në industri.

Lendet drusore, sharohen së gjati në makinën sharre-shirit vertikale. Hapat që ndiqen janë:

- Pergatitet sharra shirit për punë
- Kontrollon instrumenti prerës, shirit
- Vendoset instrumenti në makine
- Behet shtrengimi i shiritit
- Rregjistrohet trashësia e prerjes së derrisës ose elementit sipas modelit të sharrimit të zgjedhur dhe kërkesës për prodhim
- Lenda drusore transportohet me makinën ngarkuese përmes elevatorit, nga sheshi i depozitimit për në platformën e karrelit.
- Vendoset lenda drusore në karrel. Realizohet sharrimi i trupave duke kontrolluar cilësinë e sharrimit, përmasat e produktit lëndës e realizuar (Figura 2).

Kapaciteti i projektuar i sharrimit dhe përpunimit mendohet se arrijë deri në 10.000 m³/ vit i lëndës drusore.

Të gjitha operacionet që zhvillohen në secilin nga pajisjet përkatëse menazhohen nga punonjësit të cilët kanë eksperiencë disavjeçare dhe të trajnuar për prodhimin e paletave. Proceset e prodhimit të paletave zhvillohen në kushte të plota sigurie.

Elementet përbërës të procesit të prodhimit të paletave janë:

- Sigurimi i distancës së sigurisë nga instalimet/makinerite;
- Hapësira e mjaftueshme për manovrimin e punonjësve;
- Kontrolli i pajisjeve/makinerive përpara cdo procesi prodhimi;
- Sigurimi që sistemi i MKZ është në gjendje pune;
- Vënia në punë e pajisjeve/makinerive;
- Kontrolli i procesit të prodhimit;
- Menaxhimi i cilësive të produkteve;
- Kontrolli i impiantit të kapjes/trajtimit të pluhurave
- Heqja me kujdes të produktit të prodhuar dhe Sistemimi i produkteve të prodhuara
- Pastrimi i ambientit të shërbimit nëse është e nevojshme;
- Përgatitja e instalimeve/makinerive, për produktin e radhes;

Ndërtimi i linjës elektrike

Në varësi të llojit të pajisjeve dhe fuqisë së instaluar është zgjedhur edhe fuqia e transformatorit të kabinës elektrike e cila është në pronesi të shoqërisë (Figura 3). Aktualisht rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike është në gjendje mjaft të mirë dhe kuadri elektrik është i plotësuar. Instalimet e pajisjeve për prodhimin e paletave në të gjitha ambientet e tyre janë pajisur me kaseta të shpërndarjes së energjisë elektrike. Për mbrojtjen nga shkarkimet atmosferike janë parashikuar sisteme tokezimi të veçanta për cdo pajisje. Përpos kësaj, sikurse shikohet në figurën 5, kompania ka instaluar në catine objektit edhe Panolet fotovoltaike për nevojat e saj.



Figure 2. Pamje e ambienteve te brendshme te instalimit per prodhim paletash



Figure 3. Kabina e transformatorit e vendosur ne pjesen e pasme te godines



Figure 4. Produkti perfundimtar (paleta) gati per transport



Figure 5. Pamje e catise me panele fotovoltaike per prodhim energjie per instalimin.

2.2. MENAXHIMI I INSTALIMIT

- Lënda e pare

Lendet e pare blihet nga subjekte te tjera te lincensuara per prodhimin e saj, ose sigurohet nga vete shoqeria nga kontratat e shfrytezimit qe ajo ka lidhur me disa NJQVi. Me lenden e pare te blere nenkuptojme lendet te cilat sherbejne per prodhimin e paletave, te cilat jane kryesisht: lende (trupa) te pasharruar dhe aksesore te ndryshem. Menaxhimi | instalimit behet nga nje staf i kualifikuar dhe trajnuar per te operuar dhe per te ushtruar aktivitetin per prodhimin e paletave.

Per zhvillimin e aktivitetit te saj, shoqeria konform te gjitha rregullave, teknike, tatimore, fiskale dhe atyre mjedisore, eshte organizuar ne menyre te tille qe te funksionoje ne formen e nje organograme per realizimin sa me eficient dhe te sukseshem, e cila tregon menyren e funksionimit, ndarjen e detyrave dhe pergjegjesive te secilit punonjes dhe per secilin repart prodhimi.

- Sistemi i sigurise dhe mbrojtja nga zjarri

Objekti është i ndërtuar me planimetri të rregullt dhe ka respektuar kriteret teknike për funksionimin normal të tij. Ai ka sipërfaqe të mjaftueshme për kryerjen e proceseve të lëvizjes së lirë të punonjësve (Figura 6). Punonjesit jane te pajisur me veshjet e tyre specifike qe i mbrojne edhe nga aksidentet



Figure 6. Pamje e ambienteve te jashtme te instalimit

- **Siguria e Instalimit/ Impiantit**

Për mbrojtjen e instalimit nga bllokimi apo avaritë e ndryshme teknike rënia nën tension, rënia e zjarrit, bllokimi i impiantit/makinerive nga papastërtitë e lëndës së pare, lëvizja e punonjësve dhe mjeteve të transportit të brendshëm, etj janë marre keto masa:

- Percaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën perkatese.
- Brenda objektit kryhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta të tipit mbetje të perziera urbane, keto mbetje grumbullohen dhe periodikisht depozitohen në vendin e caktuar nga Njësia Vendore ku janë vendosur kosha selektive.
- Menaxhimi i mbetjeve të tallazhit të gjeneruara nga proceset për prodhimin e paletave

Paisjet e reja janë me të avancuara dhe një sërë veprimesh i kanë të automatizuara duke shmangur kështu nderhyrjen e punonjësve dhe të punuarit pranë tyre, për veç të tjerash shoqëria ka disa rregulla strikte të cilat zbatohen me rigorozitet për mos nderhyrjen në makineri gjatë punës, stakimit të energjisë para fillimit të kontrollit apo mirembajtjes e remontit të tyre, etj.

2.3.NDIKIMI NE MBULESEN BIMORE

Pozita gjeografike, ndërtimi gjeologjik, kushtet klimatike, pasuria ujore dhe lloji i tokave të territoreve të Lushnjes kanë krijuar habitate të përshtatshme për botën e gjallë bimore e shtazore. Pozicioni gjeografik dhe veçoritë e kushteve natyrore e pozicionon territorin e bashkisë së Lushnjes në biorajonin e tipit Mesdhetar.

Objekti në të cilin është vendosur instalimi ka qenë pjesë e zonës industriale të Lushnjes që përpara viteve 1990 dhe konkretisht shërbyer si reparti i pllakave bituminoze. Sot ende përreth objektit të rikonstrktuar plotësisht, vihen re ndertesat e degraduara industriale përpara viteve 90 (Figura 7). Në këto kushte është e vështirë të diskutohet për praninë e florës apo faunës në afërsi të instalimit. Mbulesa bimore dominohet nga bimë të egra në gjendje të degraduar si trendafili i eger (*Rosa canina*), Mëllaga e egër (*Malva sylvestris* L.), trasta e bariut (*Capsella bursa-pastoris*), nejtca piper uji (*Polygonium hydropiper* L.), çikorja ose radhiqja, (*Cichorium intybus* L.), laboti heshtak (*Atriplex hastatum* L.), agrimonia (*Agrimonia eupatoria* L.), grami zvaranik (*Agropyrum repens* L.), etj.

Zona e projektit nuk karakterizohet nga habitate të pacenuara ose natyrore, peisazhe me vlera të rëndësishme skenike apo biodiversiteti (florës dhe faunës) me interes për ruajtje.

Nga sa më sipër mund të thuhet që instalimi nuk do të ketë asnjë ndikim negativ në floren apo vegjetacionin e zonës. Përkundrazi, subjekti ka marrë masa për ta gjelberuar zonën rreth objektit duke mbjellë rreth 250 fidane tuje (*Thuja plicata*).



Figure 7. Bimesi e degraduar ne objektet ne afersi te instalimit

2.4.SHKARKIMET

- Shkarkimet ne ajer

Nga proceset e prodhimit te paletave gjenerohen grimca pluhuri te cilat jane karakteristike per veprimtari te tilla. Grimcat e pluhurit gjenerohen ne repartet e perpunimit te lendes se pare. Shoqeria ka marre masat e nevojshme qe ne secilin nga proceset qe kryhet ne objekt te mundesoje kapjen e pluhurave dhe dergimin e tyre ne impiantin e trajtimit.

- Shkarkime ne ujera

Shkarkimet ne ujera jane shpesh problematike ne veprimtarite e lendes se drurit sidomos nese kemi te bejme me trajtimin kimik të drurit e lëndës së drurit (psh procesi i lysterjes se mobiljeve) ku lind nevoja e pastrimit dhe larjes se ambientit te lysterjes.

Ne rastin e ketij instalimi, proceset e punes per prodhimin e paletave nuk perfshijne perdorimin e ujit. Uji qe gjenerohet dhe qe shkarkohet eshte kryesisht uji qe perdoret per pastrimin e ambienteve te punes. Keto ujera grumbullohen nepermjet rrjetit te brendshem dhe te jashtem te kanalizimeve dhe orientohen per ne puseten dekantuese te e cila sherben edhe si pusete kontrolli. Ujerat e gjeneruara nuk kane elemente te rrezikshem apo toksike dhe nuk jane te demshme per mjedisin ujqor prites.

- Gjenerimi i zhurmave

Proceset perpunimit te lendes se pare drusore dhe montimit te paletave shoqerohen me gjenerim te zhurmave. Proceset zhvillohen kryesisht brenda objektit dhe jane te ndara ne reparte te caktuara. Pajisjet dhe makinerite jane bashkekohore dhe jane te montuara ne bazamente gize te cilat mundesojne shuarjen e vibrimeve dhe eleminimin e zhurmave. Zhurmat jane te kontrolluara dhe gjenerohen vetem brenda reparteve te prodhimit. Operatori ne menyre periodike kryen mirembajtjen e instalimeve por edhe nese veren se gjenerimi i zhurmave eshte mbi normat e lejuara.


Mbetjet teknologjike

Nga procesi i prodhimit te paletave kemi gjenerim te mbetjeve. Natyre e mbetjeve eshte e parrezikshme. Mbetjet qe gjenerohen ne repartin e perpunimit te lendes drusore te cilat jane copa druri grumbullohen ne konteniere metalike me qellim riperdorimin e metejshem te tyre duke prodhuar mozaike te ndryshem me copa drurite cilat kerkohen nga kliente te ndryshem per dekorime te brendshme. Ndersa mbetjet e tallazhit te cila gjenerohen nga pluhurat e kapura nga impianti i trajtimit te pluhurave shkarkohen direkte ne thase BIGBAGS dhe magazinohen perkoheisht me qellim dergimin e tyre drejt operateve te licencuar per prodhimin e pelletit per ngrohje.

3. MONITORIMI

3.1.PLANI I MENAXHIMIT DHE MONITORIMIT TE MJEDISIT

Rolin dhe përgjegjësin kryesore të monitorimit dhe rehabilitimit të mjedisit e ka investitori, ose në rast delegimi të zbatimit të punimeve, subjekti ndërtues/nenkontraktor. Institucionet përgjegjëse për mbikqyrjen janë: Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), Agjencia Rajonale e Mjedisit (ARM), Struktura Përgjegjëse Inspektuese për Mjedisin (ISHM), Njësia e Qeverisjes Vendore (NJQV), Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), si dhe vetë subjekti investitor ose nenkontraktori i zgjedhur për këto qëllime. Paraqitja në formë skematike e zinxhirit ndër-institucional përgjegjës për raportimin dhe monitorimin e punimeve ndërtimore dhe të rehabilitimit.



3.2.KERKESAT LIGJORE PER KRYERJEN E MONITORIMIT.

- Ligji nr. 10431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar, kreu VI "monitorim i gjendjes së mjedisit";

- Subjekti është i detyruar të kryejë monitorimet periodike sipas kërkesave të përcaktuara në kushtet e lejes përkatëse mjedisore.

- **Baza ligjore për monitorim:**

Ligji Nr.162/2014	Për mbrojtjen e cilesise se ajrit ne mjedis
Ligji Nr. 9774 datë 12.07.2007	Për vierësimin dhe administrimin e zhurmës në Mjedis
VKM Nr.1189 datë 18.11.2009	Për Rregullat dhe Procedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit
VKM Nr. 435, datë 12.09.2002	Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë

VKM Nr. 803 datë 04.12.2003	Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit
VKM Nr. 412, datë 19.6.2019	Për miratimin e Planit Kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit
Udhëzimi Nr.8 datë 27.11.2007	Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara

Monitorimi është detyrë e shoqërisë investitore në nivel individual për pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 të Vendimit Nr.1189. datë 18.11.2009 “Për monitorimet në Republikën e Shqipërisë”. Frekuenca e monitorimeve do të përcaktohet sipas kuadrit ligjor, ku operatori i nje leje mjedisi te tipit B, duhet te kryej vetemonitorimin e ndikimeve ne mjedis te aktivitetit dhe i raporton ato rregullisht te paktën dy here ne vit prane AKM-se. Gjithashtu, raportimi periodik permban edhe informacion per masat e marra per mbrojtjen e mjedisit.

3.3.MONITORIMI I ELEMENTEVE TE MJEDISIT.

Monitorimi i cilesise se mjedisit dhe i nivelit te elementeve ndotes se tij, shkarkimet ne ajer, ne uje, ne toke dhe demtimi i mjedisit biologjik, kryhet sipas disa kriterëve shkencore per sa i perket vrojttimeve, mbledhjes dhe analizimit te mostrave te ujit dhe te tokes, ndersa per sa i perkete ndotjes se ajrit ai monitorohet direkt ne terren. Procesi i monitorimit synon mbledhjen e te dhenave te nevojshme per te vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror ne ndryshimet e mjedisit, ku ai eshte aktiv. Objektivat kryesore te monitorimit jane:

- Per te zbuluar ndryshimet dhe per te karakterizuar saktësisht nga ana sasore tendencat (prirjet) e zhvillimit te burimeve.
- Per te siguruar informacione midis lidhjes se gjendjes dhe nivelit te burimeve te ndotjes dhe shkaqeve te tyre.
- Per te evidentuar cilesine e mjediseve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetesor ose ekonomik, me synim per te marre masat e nevojshme per reduktimin e shkarkimeve dhe permiresimin e cilesise se elementeve te mjedisit.
- Per te vleresuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve per menaxhimin e burimeve natyrore te hartuara dhe te ndermarra.

Procesi i monitorimit ne rang individual, sipas ligjit per mbrojtjen e mjedisit, eshte detyre e shoqerise investitore/operatorit te pajisur me leje mjedisi ose e nenkontraktorit te zgjedhur per kete gellim, per elementet ne te cilat ai ndikon. Sipas VKM Nr.1189. date 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit” pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 mund te monitorohen nga vete investitori. Monitorimi te kryhet per shkarkimet ne ajer, zhurmat, cilesine e burimeve ujore, si dhe per punimet e rehabilitimit.

Bazuar ne Ligjin Nr 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, Kreu VI, Monitorimi i Gjendjes së Mjedisit, Seksioni 2, Monitorimi i Perputhshmërisë, Neni 44, Detyrimet e operatorit për monitorimin e përputhshmërisë janë:

- Operatori i veprimtarive, të përfshira në kategoritë A, B dhe C, të referuara në nenin 29 të këtij ligji, monitoron shkarkimet e veprimtarisë së tij, në përputhje me dispozitat e legjislacionit për lejet e mjedisit dhe kushtet e përcaktuara në lejen përkatëse të mjedisit.
- Operatori i referuar në pikën 1 të këtij neni monitoron burimet e shkarkimit të veprimtarisë së vet dhe kryen monitorime të tjera, duke përdorur pajisje dhe instrumente të miratuara, përmes procedurës për verifikimin e matjeve, të parashikuara në legjislacionin e posacëm dhe në pajtim me kushtet e përcaktuara në lejen përkatëse të mjedisit, si dhe mban këto pajisje e instrumente në një gjendje të përshtatshme pune.
- Operatori mund të kryejë monitorimin nëpërmjet pajisjeve dhe instrumenteve të akredituara që ai disponon ose nëpërmjet laboratorëve të specializuar e të akredituar.
- Rezultatet e vetëmonitorimit u jepen autoriteteve përkatëse në përputhje me legjislacionin për lejet mjedisore dhe me kushtet e përfshira në lejen përkatëse mjedisore.

4. PERSHKRIMI I MASAVE TE TJERA PARANDALUESE TE PLANIFIKUARA

4.1.MASA LEHTËSUESE TË PROPOZUARA

Për funksionimin eficient dhe të sigurtë të punës në aktivitetin e prodhimit të paletave propozohet të ndermerren keto masa:

- Të shmanget në maksimum përdorimi i mjeteve të transportit kur nuk është e nevojshme dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona.
- Të vendosen kontener për mbajtjen pastër të ambjenteve nga mbetjet urbane për numrin punonjësve dhe sasine e gjeneruar nga instalimi.
- Mbetjet të Rikuperohen, Riciklohen dhe Riperdoren perseri në linjen e prodhimit. Sasia e mbetjeve që nuk mund të riciklohet apo të rikuperohet, duhet të asgjësohet nga subjekte të licencuara.
- Investitori të respektojë detyrimet e vendosura në Lejen Mjedisore që do të miratohet nga AKM.
- Subjekti të jetë në dijeni dhe të azhurnohet për kuadrin ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.
- Subjekti të respektojë dhe zbatojë kushtet teknike në objekt për mbrojtjen nga zjarri dhe të krijojë infrastrukturën e nevojshme për zjarrfikset.
- Të kryhet monitorimi i indikatorëve të mjedisit sipas ligjeve në fugi.

Si rezultat i realizimit të projektit nuk do të absorbohen ndikime të rëndësishme mjedisore, sociale në shëndetin e njerëzve. Për pasoj ndikimet e parashikuara mund të minimizohen duke zbatuar masat e përmendura më sipër. Nga analiza për identifikimin e ndikimeve rezulton se ndikimi do të jetë i drejtpërdrejtë, i shkaktuar vetëm nga linja e prodhimit. Është detyrë e zbatuesve të projektit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social. Është detyrë e Njesisë Vendore gjithashtu të zbatojë rigorozisht detyrimet e përcaktuara për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit. Është detyrë e të gjithë kontraktorëve e nënkontraktorëve të ndryshëm si gjatë fazës së prodhimit të zbatojnë me kujdes detyrimet përkatëse të parashikuara më sipër.

4.2.MASA LEHTËSUESE TË TJERA TE KERKUARA

- Do të bëhet një menaxhim sa më me eficient të energjisë elektrike, sidhe kursim të energjisë elektrike nga përdorimi i makinerive/impianit me eficientë.
- Subjekti të kryej aktivitetin për prodhimin e paletave vetëm brenda kordinatave të sipërfaqes së pronës/ndertesës që disponon në pronësi.
- Do të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet, emetimin e pluhurave, ujrave dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga proceset e prodhimit dhe lëvizjes së mobiljeve.

- Linja e Impiantit të prodhimit të paletave, do të koluaidohet në mënyrë periodike nga teknikë të specializuar dhe certifikuar për të tilla procese.
- Veglat/Pajisjet/Makinerite e punës që shërbejnë për procese të ndryshme do të zëvendësohen me të reja, sipas jetëgjatësisë së tyre dhe efikasitetit që kanë në kryerjen e operacioneve të prodhimit dhe lëvizjes së mobiljeve
- Maksimizimi i përdorimit të lëndës së parë.
- Do të bëhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta, të cilat do të jenë; lëndë të ambalazheve, letra, kartona, si dhe lëndë organike të prodhuara nga punonjësit, ku këto mbetje do të transportohen rregullisht në vendin e caktuar nga Njësia Vendore, ku firma do të marrë masa për menaxhimin e këtyre mbetjeve të ngurta, do të vendosen në kosha selektive sipas rrymave specifike të mbetjeve.
- Rrjeti elektrik është tërësisht i përbashkët për të shmangur ndonjë shkarkesë elektrike, konform kushteve teknike, Janë ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme të mbrojtjes kundër zjarrit.
- Për të mbrojtur kundër zjarrit të mundshëm që mund të bjerë do të ruhen largësitë mbrojtëse ndaj zjarrit të objektit dhe linjës së prodhimit. Aktiviteti i disponon infrastrukturën e nevojshme, me distancat e përcaktuara për rrugë kalim të punonjësve, automjeteve, zjarrëfiksive, etj.
- Ndërsa në lidhje me burimet e furnizimit me ujë, janë të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat gjatë një viti, veçanërisht gjatë muajve të verës, kur normalisht kërkesa është më e lartë.
- Furnizimi me ujë sigurohet në një nivel të tillë presioni, në mënyrë që të jetë i mjaftueshëm për të shpërndarë sasinë e nevojshme të ujit në të gjithë gjatësinë e objektit dhe instalimit, por jo aq sa të demtojë pajisjet hidraulike (efekti i grushtit hidraulik) ose të krijojë rreziqe tek impianti apo aparatat dhe jetën e punonjësve. >
- Do të bëhet trajnimi periodik i punonjësve mbi kushtet e sigurimit teknik gjatë operimit të punës, si dhe të kualifikohen stafi përgjegjës për operimin e punës në linjen e prodhimit dhe lëvizjes së mobiljeve.

5. REHABILITIMI, NDERPRERJA E VEPRIMTARISE, RIFILLIMI DHE KONTROLI PAS NXJERRJES NGA PERDORIMI

Nderprerja perfundimtare e veprimtarise, apo transferimi i aktivitetit ne nje vendodhje tjeter, sjell si rrjedhoje nevojen per mbylljen dhe rehabilitimin e mjedisit. Ne lidhje me kete hartohet nje plan per mbylljen dhe rehabilitimin qysh ne faze te hershme kur operatori pajiset me leje mjedisi dhe e rishikon ate ne momentin e mbylljes dhe zbatimit te ketij plani. Ne lejen mjedisore te tipit B, ky proces parashikohet ne kushtin nr. 14 te lejes se mjedisit. Plani i mbylljes dhe rehabilitimit konsiston ne keto procese:

- Cmontimi i pajisjeve/makinerive, transporti i tyre ne vendodhjen e re, ose per ne pikat e riciklimit/ asgjesimit ne rast se nuk do te riperdoren.
- Instalimi ne vendodhjen e re ne rast se aktiviteti transferohet.

Objekti ne te cilin do te zhvillohet aktiviteti, eshte objekt ekzistues, eshte ne gjendje te mire dhe plotesisht funksional, nuk do te kryhet rikonstruksion dhe ne rast çmontimi, nuk do te kete prishje te objektit dhe rehabilitim te mjedisit natyror. Gjate zhvillimit te aktivitetit subjekti nuk do te kryehet asnje nderhyrje ne strukturen e objektit. Nuk do te kete mbyllje dhe rehabilitim te objektit, por mund te kete vetem cmontim dhe largim te pajisjeve.